

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6697  
E hënë, 5 shtator 2022  
çmimi 0.40

## Rama për "Der Spiegel"- in: Vendimi për pavarësinë e Kosovës ishte i duhuri

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI DHE MINISTRJA E DREJTËSISË, ALBULENA HAXHIU,  
MBAJNË KONFERENCË PËR MEDIE PËR VETTINGUN NË DREJTËSI

# QEVERIA E DORËZON NË KUVEND DOSJEN PËR VETTINGUN NË DREJTËSI

- KPK-ja dhe Prokurori i  
Shtetit: Deklaratat e Kurtit  
dhe të Haxhiut, të pasakta  
dhe tendencioze



Qeveria e Kosovës e ka dorëzuar në Kuvend dosjen për vettingun në drejtësi. Këtë dosje kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ia kanë dorëzuar kryeparlamentarit Glauk Konjufca. Para se ta dorëzonin dosjen për vettingun në drejtësi, Kurti dhe Haxhiu në një konferencë të përbashkët për

medie kanë folur për rëndësinë e këtij procesi dhe kanë hedhur akuza në adresë të sistemit të drejtësisë. Ndaj këtyre akuzave kanë reaguar Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Prokurori i Shtetit, duke i quajtur të pasakta dhe tendencioze deklaratat e Kurtit dhe Haxhiut

## AKTUALE



PRESIDENTI I SLLOVENISË TË  
MËRKURËN VIZITON KOSOVËN F. 4

OSMANI: JAM KRENARE  
ME SHEMBULLIN QË LA PAS NËNË  
TEREZA F. 6

BËRNABIQI SOT VJEN NË KOSOVË,  
BISLIMI E NAGAVCI SHKOJNË NË  
LUGINË F. 5

KRASNIQI NË "HARDH FEST":  
RAHOVECI, PIKËTAKIM I  
DASHAMIRËVE TË VERËS DHE  
MUZIKËS F. 6



## EKONOMI

ASK-ja: RRITEJN ÇMIMET  
E IMPORTIT NË KOSOVË F. 8

KRYETARI I OEK-ut: BIZNESET  
PO BALLAFAQOHEN ME SFIDA  
TË SHUMTA F. 8

MINISTRI PEÇI: FERMERI NË KOSOVË  
ËSHTË MË I PËRKRAHURI NË RAJON

F. 8

## SPORT

BALLKANI FITON DERBIN NDAJ  
PRISHTINËS F. 10



### 150 MILIONËT E KURTIT S'I NDALIN KRITIKAT DHE GREVËN E MËSIMDHËNËSVE

FAQE 3



### HARADINAJ TAKON JASHARAJN: KA VETËM NJË ZGJIDHJE, RRRITJA E PAGAVE

FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Gjermania ndan 65 miliardë euro për t'i mbrojtur bizneset nga rritja e inflacionit



PRISHTINË, 4 SHTATOR - Gjermania do t'i shpenzojë 65 miliardë euro për t'i mbrojtur klientët dhe bizneset nga rritja e inflacionit, ka thënë kancelari Olaf Scholz të dielën, dy ditë pasi Rusia ka njoftuar se do t'i pezullojë disa dërgesa të gazit për një kohë të pacaktuar. Tri partitë në koalicionin qeverisës kanë diskutuar deri në orët e vona të natës përpara se t'i shpallnin masat, të cilat përfshijnë një taksë për kompanitë e energjisë, ndihmë për pagesën e faturave të energjisë elektrike dhe subvencion për transportin publik. Pushtimi rus i Ukrainës në shkurt ka nxitur inflacionin në mbarë botën. Në Gjermani efekti është përkeqësuar nga

reduktimi i vazhdueshëm i Rosisë në vëllimet e gazit, i cili ka shkaktuar rritje të çmimit të energjisë.

"Rusia nuk është më një partner i besueshëm i energjisë", ka thënë Scholzi në një konferencë për medie.

Derisa furnizimet me energji janë në sasi të mjaftueshme, qeveria do të duhet të ndihmojë në mbrojtjen e konsumatorëve dhe bizneseve nga kostot më të larta, ka thënë ai. "Nuk do të ecësh kurrë vetëm", ka thënë ai në anglisht, përpara se të vazhonte në gjermanisht: "Askush nuk do të mbetet vetëm".

Kriza e energjisë është ashpërsuar kur gjiganti energjetik i kontrolluar nga

shteti rus "Gazprom", ka thënë të premten se po mbante të mbyllur tubacionin e tij kryesor "Rrjedha Veriore 1", tubacioni më i madh i vetëm që transporton gazin rus në Gjermani.

Ndër masat kryesore ishte një taksë e papritur për kompanitë energjetike, për të cilën ministri i Financave, Christian Lindner, ka thënë se ajo do të sillte të ardhura "dy miliardësh". E riemërtuar si taksë rastësie, kjo ishte një nga masat më të diskutueshme. Një pjesë e të ardhurave do të përdoren për të ofruar 1.7 miliard euro lehtësim taksash për 9 000 kompani me energji intensive, tregoi një dokument qeveritar.

## BE-ja: Jemi të përgatitur edhe nëse Moska e ndërpret tërësisht furnizimin me gaz



BRUKSEL, 4 SHTATOR - Evropa është "e përgatitur mirë" falë kapaciteteve të magazinimit dhe masave për ruajtjen e energjisë nëse Rusia vendos ta ndërpresë plotësisht furnizimin me gaz, ka thënë një udhëheqës i lartë i BE-së në mes të një beteje energjetike midis Rosisë dhe Perëndimit për shkak të luftës në Ukrainë. "Ne jemi të përgatitur

mirë për t'i rezistuar përdorimit në nivel ekstrem si armë të gazit nga Rusia", u ka thënë gazetarëve komisionari i BE-së për ekonominë, Paolo Gentiloni, gjatë një forumi ekonomik në Itali. "Ne nuk kemi frikë nga vendimet e presidentit rus Vladimir Putin, ne po kërkojmë nga rusët t'i respektojnë kontratat, por nëse ata nuk e

bëjnë këtë, ne jemi të gatshëm të reagojmë", ka thënë ai. Komentet e Gentilonit pasojnë vendimin e Moskës të premten për ta shtyrë rihapjen e tubacionit të saj kryesor të gazit që e lidh Rosisë me Gjermaninë. Rusia, përmes këtij vendimi, po reagon ndaj marrëveshjes së grupit të shtatë vendeve më të industrializuara të botës për ta

kufizuar çmimin e eksporteve të naftës ruse me synim për t'i pakësuar fitimet e Moskës.

Gentiloni ka thënë se qendrat e magazinimit të gazit në Bashkimin Evropian "aktualisht janë të mbushura në një nivel rreth 80 për qind falë politikave të zgjerimit të burimeve energjetike, megjithëse situata dallon nga vendi në vend.

Gjiganti rus i energjisë "Gazprom" ka thënë se nuk mund ta rifillonte furnizimin me gaz natyror në Gjermani vetëm disa orë para se t'i rifillonte furnizimet përmes gazsjellësit "Nord Stream 1". Rusia ka bërë me dije se arsyeja e ndërprerjes ishte një defekt teknik në tubacion, i cili ka të ngjarë ta përkeqësojë krizën energjetike në Evropë.

# 150 milionët e Kurtit s'i ndalin kritikrat dhe grevën e mësimdhënësve

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Greva në sektorin publik është duke vazhduar dhe duket se nuk do të përfillet kërkesa e kryeministrit Albin Kurti që mësimdhënësit të kthehen të hënën në shkollë. Kurti të shtunën në një konferencë për medie ka thënë se mësimdhënësit po prodhojnë analfabetë, ndërsa ka folur për një pako të re për ta shuar sadopak pakënaqësinë me qeverisjen e tij. Presidentja Vjosa Osmani është duke ndërmjetësuar në mes të qeverisë dhe sindikatave të punëtorëve, por deri tani pa sukses.

Javën që shkoi nuk ka pasur mësim në shkollat e Kosovës. Mësimdhënësit dhe punëtorë të tjerë të sektorit publik janë në grevë. Pagat e gushtit s'i kanë marrë ende, pasi që qeveria nuk dëshiron t'i paguajë ata që mbajnë grevë. Ministri i Financave, Hekuran Murati, para pak ditësh kishte njoftuar se është bërë ekzekutimi i pjesës së pagave për muajin gusht për shkak se nuk është përditësuar me kohë lista e personelit që ka punuar deri në fund të muajit. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se njerëzit "nuk duhet të paguhen për mospunën". Ai është duke refuzuar ta takojë kreun e Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rrahman Jasharaj. Për të, takimi me Jasharaj është i panevojshëm dhe "e prishë rregullsinë" e shtetit, shkruan "GE".

Kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve drejtuar qeverisë është ndarja e 100 eurove për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Ligji për Paga. Këto kërkesa Kurti i ka quajtur irracionale të shtunën. Në një konferencë për medie ai njoftoi për ndarjen e 150 milionë eurove për një pako të re për përballje me inflacionin. Me këtë pako parashihet edhe ndarja e 50 eurove shtesë për punëtorët e sektorit publik nga muaji shtator. Kurti ka thënë se sindikalistët kanë "dëshirë delirante" në vend të "kërkesave racionale", ndërsa foli pak se si duhet të jetë, sipas tij, imazhi i tyre. Kërkesat e sindikatave Kurti i sheh si kërcënim dhe shantazhim ndaj qeverisë së tij me "rënimin të shtetit".

"Është papërgjegjësi absolute. Ne nuk shantazhohemi", ka thënë Kurti. Si kurrë më parë, Kurti të dielën ka vendosur t'i godasë mësimdhënësit, për të cilët shpresonte se nuk do ta përfillnin sindikatën, por do ta dëgjonin ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci. "Pikërisht duke nxjerrë analfabetë funksionalë e duke menduar veç për paga, po na përfundojnë njerëzit veç për asistencë sociale. Kur ti nuk nxjerr quadro të mira arsimore, atëherë prodhon ose njerëz për asistencë sociale, ose punëtorë krahu në Gjermani. Ne duhet ta rregullojmë sistemin arsimor, por ju po e shihni se çka po ndodh. Veç kërkesë për para, për ta bankrotuar shtetin, për ta



shkatërruar shtetin. Është papërgjegjësi totale", ka thënë Kurti.

## Presidentja Osmani takoi Jasharajn

Në rolin e ndërmjetësues, presidentja Vjosa Osmani e ka pritur të shtunën në zyrë kreun e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili paraprakisht ka shprehur optimizëm se ajo do t'i ulte në një tavolinë përfaqësuesit e qeverisë dhe ata të sindikatave. Pas takimit, Jasharaj ka thënë se Osmani i ka konsideruar legjitime kërkesat e tyre. "Në takim me presidenten paraqitëm kërkesat tona, të cilat edhe ajo tha se janë legjitime. Ne e lutem presidenten që ta shfrytëzojë autoritetin e saj në mënyrë që të ndikojë që të ulemi për të diskutuar me përfaqësuesit e qeverisë për realizimin e kërkesave tona. Qeveria mund të japë ndihma për punëtorët dhe ne i gëzohemi kësaj, por kërkesat tona janë të tjera. E vlerësoj angazhimin e presidentes por, për fat të keq, greva do të vazhdojë", ka deklaruar Jasharaj para gazetarëve të shtunën. Ndërsa presidentja Osmani ka thënë se qeveria tashmë e kishte bërë "një hap të rëndësishëm" për gjetjen e një zgjidhjeje për këtë situatë. "Me prezantimin e pakos ekonomike, Qeveria ka bërë një hap të rëndësishëm për zgjedhjen e kësaj zgjidhjeje. Tani është koha që sindikatat ta tregojnë një vullnet të mirë, që mësimdhënësit t'i hapin shkollat të hënën në mënyrë që të krijohet një atmosferë krejtësisht e re, ku të gjitha palët ulen dhe i tregojnë kërkesat e tyre", ka thënë ajo.

## Ministri Murati u mbulua me miell, Kurtit i reagojnë në rrjetet sociale

Pas konferencës së përbashkët për medie me kryeministrin

Albin Kurti, ministri i Financave, Hekuran Murati, është mbuluar me miell tekta po ecte në kryeqytet. Dy aktivistë të PSD-së kanë hedhur miell në këtë aksion "kundër qeverisë së krizës".

Frashër Krasniqi nga kjo parti e ka quajtur frikacak Kurtin, duke thënë se sindikatat e arritën gjysmën e suksesit. "Pyetja është pse 50 euro? Pse jo 100 euro? Albin Kurti po bën pazar. Sindikatat po bëjnë rezistencë të drejtë. Gjysmën e suksesit e mbërritën, me pak insistim do të mbërrinë sukses të plotë. Mos harroni: Albin Kurti është tuc. Veç presionin e rezistencën e di hak", ka thënë ai.

Ndërsa analisti dhe gazetari Astrit Gashi i ka quajtur vitra masat e reja të qeverisë për t'u dalë në ndihmë qytetarëve. Në anën tjetër, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka reaguar vetëm me një fjali: "Kryeministër, lej pallavrat, qiti rrogat!".

Kurse kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se Kurti ka dështuar ta kapërcejë veten, duke thelluar përçarjen. "Kurti dështoi të kapërcejë veten. Refuzoi dialogun dhe nuk arriti të trajtojë me respekt shtetari problemin e mësimdhënësve tanë - njerëzve të këtij vendi. Zgjidhjet e tij të njëanshme që nuk plotësojnë nevojat themelore të mësimdhënësve, janë veçse improvizim. Si i tillë, ky plan pa dialogim, thellon përçarjen e mbanë shkollat tona të mbyllura", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Më tutje, kanë reaguar edhe nënkryetarët e dy partive më të mëdha opozitare. Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se Kurti i ka poshtëruar mërgimtarët. "Diasporën që tash e 60 vjet e mban gjallë këtë vend, e 23 vjet pas luftës e ruan paqen sociale, kurrkush nuk e ka goditur e ofenduar në këtë masë sa Albin Kurti. Me i quaj 'alalfabetë funksionalë' mërgatën tonë, është poshtërimi e lëndimi më i madh që ua ka

bërë dikush ndonjëherë", ka shkruar Haziri.

Për nënkryetaren e PDK-së, Vlora Çitaku, për deklaratën kundër mërgimtarëve, Kurti ka marrë shkas diku. "Albin Kurti i ka parë sondazhet e njëjta nga diaspora që i kemi parë edhe ne. Prandaj, ai sot i ofendoi bashkatdhetarët tonë në diasporë duke i quajtur analfabetë. Edhe PDK-ja ka pasur në zgjedhjet e kaluara rënie votash në diasporë, por ne asnjëherë nuk i kemi ofenduar e përbuzur bashkatdhetarët tonë", ka shkruar ajo në "Facebook".

## Kurti për sulmin me miell kundër Muratit: E bënë për inati

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka folur për aksionin e PSD-së gjatë ditës së shtunë, ku

disa aktivistë të kësaj partie e gjuajtën me miell ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati.

Kurti ka theksuar se pas prezantimit të pakos ekonomike për përballimin e inflacionit në Kosovë nga qeveria, nuk mund të ketë kritika, por vetëm inat. "Nëse je diçka kundër pakos që e propozuam gjatë ditës së djeshme mund të marrësh edhe aksion kundër ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, që kishte të bënte me pakon ekonomike që do ta ndajmë për qytetarët për përballje me inflacionin në vlerë prej 150 milionë eurosh. Kjo do të thotë se nuk kemi të bëjë me kritika, por veçse me inat. Mund të jesh kundër kësaj pakoje ose mund të jesh i udhëhequr nga inati secila më keq se tjetra", ka thënë Kurti të dielën në një konferencë për medie.

Ndaj kësaj deklarate ka reaguar kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj. Ai ka thënë se kryeministri Kurti e ka sikletin te ky subjekt pasi, siç theksuar ai, ata veprojnë jashtë domenit të tij hegjonik. "Nuk e ka hallin te inati i kujtdo. Madje do të dëshironte të ishte veç inati, që sulmi që bëri të ishte më i pranueshëm në opinion. Sikletin e ka që PSD vepron jashtë domenit të tij hegjonik. Opozitarizmi ynë nuk ndikohet dhe as frikësohet ndaj kërkesës së tij për dëgjueshmëri. Është e njëjta arsye pse i ka hipur në qafë sindikalistëve. Aty ku nuk mundet t'i nënshtrojë përpjekjet mundohet t'i depolitizojë. Përpjekje e dështuar. Sido që të jetë, z. kryeministër, lëre inatin, plotësoje kërkesën e punëtorëve!", ka shkruar Molliqaj në "Facebook".





KRYEMINISTRI ALBIN KURTI DHE MINISTRJA E DREJTËSISË, ALBULENA HAXHIU, MBAJNË KONFERENCË PËR MEDIE PËR VETTINGUN NË DREJTËSI

# Qeveria e dorëzon në Kuvend dosjen për vettingun në drejtësi

- KPK-ja dhe Prokurori i Shtetit: Deklaratat e Kurtit dhe të Haxhiut, të pasakta dhe tendencioze

Qeveria e Kosovës e ka dorëzuar në Kuvend dosjen për vettingun në drejtësi. Këtë dosje kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ia kanë dorëzuar kryeparlamentarit Glauk Konjufca. Para se ta dorëzonin dosjen për vettingun në drejtësi, Kurti dhe Haxhiu në një konferencë të përbashkët për medie kanë folur për rëndësinë e këtij procesi dhe kanë hedhur akuza në adresë të sistemit të drejtësisë. Ndaj këtyre akuzave kanë reaguar Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Prokurori i Shtetit, duke i quajtur të pasakta dhe tendencioze deklaratat e Kurtit dhe Haxhiut

**EPOKA E RE**

**Lirim GECI**

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ia kanë dorëzuar të dielën kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, dosjen e vettingut në drejtësi. Para se t'ia dorëzonin Konjufcës këtë dosje, Kurti dhe Haxhiu kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për

medie.

Kryeministri Kurti ka thënë se si qeveri që nga fillimi janë angazhuar për reformën në drejtësi, si "thelb të qeverisjes sonë, e cila edhe është themeluar nga fitorja e cila bazohej në parullën kryesore 'Punësim dhe drejtësi' apo 'Drejtësi dhe punësim'.

"Jemi bashkë me ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, që t'ju informojmë lidhur me reformën në drejtësi dhe

vettingun në sistemin gjyqësor në veçanti. Gjatë kësaj jave na tronditi të gjithëve lajmi mbi krimin që për viktimitë kishte vajzën 11-vjeçare. Në rastet si këto i humbet kuptimi zbatimit të respektimit të të drejtave të njeriut, respektimit të ligjit, ndjekjes së krimit, ushtrimit të pozitave të larta shtetërore që kanë për obligim parandalimin, përkatësisht ndjekjen e atyre që kërcënojnë sigurinë, mirëqenien dhe integritetin fizik të

qytetarëve. Kur kuptojmë që kryesi i veprës penale ka qenë i dënuar për vepra penale e gjendet i lirë, kur dështon zinxhiri institucional përgjegjës për ndjekjen penale - policia, prokuroria dhe gjykata, dështon drejtësia - kurse faturën e paguan qytetari", ka thënë Kurti, duke adresuar një mori kritikash në drejtim të sistemit të drejtësisë.

"Fuqia e cila vjen nga pozita e gjyqtarit dhe prokurorit, në vete ngërthen përgjegjësi të madhe ndaj qytetarit. Për t'i garantuar të drejtat e secilit e për ta fuqizuar sundimin e ligjit, gjyqtari vepron me urtësi e me maturi. Vepron me profesionalizëm, andaj vendimet e tij apo të saj edhe mbrohen nga vetë shteti përmes pavarësisë së garantuar me Kushtetut dhe me ligj. Gjyqësori ynë, përkundër të gjitha

garancive kushtetuese, ngjan sikur mundohet ta dëshmojë të kundërtën. I akuzuar e i dënuar për shumë vepra penale, dhunuesi ecën i lirë nëpër rrugët e Prishtinës. Dhunuesi lirohet pas 8 muajsh burgim. Dhunuesi nuk rehabilitohet. Dhunuesi e përsërit veprën. Madje dhunuesi edhe vret. Nuk ka alternativë ndaj vettingut në sistemin gjyqësor e prokurorial. Këtë e kuptojnë edhe vetë akterët e këtij sistemi, edhe ata më skeptikët për vettingun. Duhet përmendur një gjë: demokracia, sundimi i ligjit dhe të drejtat fundamentale janë baza mbi të cilën ndërtohet çdo gjë tjetër. Dhe sistemi i kontrollit dhe balancimit ndërmjet pushteteve, urtësia e votuesve, qytetarët si fuqi sovraane e cila e kupton që duhet ta mbajë e ta ruajë një demokraci të shëndoshë, janë parametrat e

## Presidenti i Sllovenisë të mërkurën viziton Kosovën

Prishtinë, 4 shtator - Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, më 7 shtator (e mërkurë) do të vijë në Prishtinë. Gjatë kësaj vizite ai pritet të takohet me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. Kjo vizitë është në

kuadër të përgatitjeve për samitin e 11 të liderëve të nismës së Procesit Brdo-Brijuni, i cili do të mbahet më 12 qershor. Disa ditë më parë Pahori ka qëndruar për një vizitë disaditore në Beograd, ku ka folur për dialogun në

mes të Kosovës dhe Serbisë, duke thënë se gjatë vizitës së tij të fundit në Kosovë ka kërkuar që ta formohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Pahori ka thënë se gjatë vizitës së tij në Prishtinë do të dërgojë disa

mesazhe të rëndësishme. "Në Prishtinë, së pari, do të them se çështjet e mbetura aktuale, në shtator dhe tetor, duhet të zgjidhen me dialog dhe, së dyti, dialogu duhet të jetë më 'i gjallë'. Mendoj se ka shumë mosbesim", ka thënë Pahori.



politikave për ndërtimin e shoqërisë dhe shtetit demokratik. Mbi këtë urtësi e besim të qytetarit, ne edhe kemi fituar qeverisjen tonë, duke marrë përsipër obligimin që këtë themel ta mbrojmë. Mbi këtë kemi ndërtuar idenë e vettingut duke gjetur bazë në parimet më të mira ndërkombëtare, të pasqyruara në opinionin e Komisionit të Venecias”, ka deklaruar Kurti.

Më tutje, Kurti ka thënë se për vettingun janë konsultuar edhe me partitë opozitare. “Me qëllim të koordinimit me të gjithë akterët politikë në vend, kam thirrur takime me liderët e opozitës, ashtu që puna e mëtutjeshme në procesin e vettingut të arrijë konsensus të plotë. Në përjashtim të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të gjithë e kanë pranuar ftesën dhe kemi zhvilluar takime. Tani, kur punën tonë e kemi bërë me profesionalizëm e në koordinim me akterët politik, duke kuptuar që vettingu është produkt i nevojave të shoqërisë, pra shtetit, procesin e vendosim në duar të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, është shprehur Kurti, duke shtuar se puna e nisur nga qeveria e tij nuk mund të përfundojë pa vettingun. “Besimi në drejtësi ngërthen në vete besimin në shtet – që ky i fundit është në funksion të mbrojtjes së të drejtave e lirive themelore, pra në shërbim të qytetarit. Duke kuptuar këtë, kemi vendosur reformën në drejtësi në vendin meritor, prioritet të qeverisë e të shtetit. Gjatë një viti e gjysmë kemi miratuar politikën e re të funksionimit të sistemit prokurorial përmes Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, e kemi finalizuar atë për Prokurorin e Shtetit dhe Prokurorinë Speciale. Për më tepër, kemi funksionalizuar Gjykatën Komerciale, e kemi votuar në parim Ligjin për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Qasja jonë aq sa sistematike ka sulmuar drejtpërdrejt politikën e gabuara e ka vendosur parime të mirëfillta, duke e vënë drejtësinë në shërbim të qytetarit. Puna e nisur nuk mund të mbarojë pa vettingun dhe sigurimin që: institucionet e parandalojnë krimin; gjykatat shqiptojnë dënime të merituar; burgjet rehabilitojnë të dënuarit, kurse qytetarët kthejnë besimin në rendin dhe ligjin e ndihen të sigurt – gjë që e ka për detyrë ta garantojë shteti. Për këtë mbetemi të përkushtuar”, është shprehur Kurti.

Ndërsa ministrja e Drejtësisë ka thënë se pas një punë intensive kanë arritur që ta dorëzojnë në Kuvend dosjen për vettingun. “Pas një pune intensive, dhe pas konsultimeve me grupe

parlamentare, sot po e dorëzojmë në Kuvendin e Kosovës dosjen e dokumenteve të vettingut, përfshirë draftin e amandamenteve kushtetuese për vettingun, projektligjin për vettingun, koncept-dokumentin për vettingun dhe, po ashtu, dokumentin shpjegues lidhur me vettingun të hartuar nga Ministria e Drejtësisë”, ka thënë Haxhiu.

Në këtë konferencë për medie ministrja Haxhiu ka folur edhe për rastin e dhunimit të 11-vjeçes. Për këtë rast janë dhënë dy dorëheqje dhe janë bërë dy shkarkime. Por, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka paralajmëruar edhe për shkarkime të tjera të zyrtarëve “që nuk i kanë kryer detyrat e tyre”. Për rastin e 11 vjeçes janë duke u zhvilluar hetimet në dy çështje të ndara penale, atë të dyshimit për dhunim më 27 gusht nga pesë persona dhe dyshimeve për trafikim, dhunim dhe shërbime seksuale në muajin qershor nga gjashtë persona të tjerë. Për të dyja rastet janë arrestuar 11 persona dhe të gjithëve u është caktuar masa e paraburgimit prej 30 ditësh.

Pas asaj që ka ndodhur, ka pasur dy dorëheqje dhe dy shkarkime. Por, ministrja Haxhiu ka paralajmëruar edhe për veprime të tjera ndaj zyrtarëve të përfshirë në rast. “Ne brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë jemi duke identifikuar persona përgjegjës që mund të ndërliidhen me rastin në mënyrë që të marrim veprime ndaj tyre”, ka thënë ajo. Haxhiu ka kërkuar edhe dorëheqjen e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Kujtim Munishi, dhe ka thënë se duhet të merren veprime edhe ndaj “prokurorëve dhe gjyqtarëve që nuk po i kryejnë detyrat e tyre”. Në konferencën e përbashkët, ku është folur për vettingun në drejtësi, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se mbi 200 gjykatës, nga 400 në total sa janë në gjithë Kosovën, kanë shqiptuar vetëm dënime me kusht, me gjobë ose kanë lejuar parashkrimin e rasteve për rastet e dhunës seksuale. “Në mbi 85 për qind të rasteve viktimat ishin vajza të mitura e rreth 140 prokurorë, nga rreth 200 sa janë në total në Kosovë, kanë lejuar parashkrimin e lëndëve për këto raste”, ka thënë Kurti.

### KPK-ja dhe Prokurori i Shtetit: Deklaratat e Kurtit dhe Haxhiut, të pasakta dhe tendencioze

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Prokurori i Shtetit kanë reaguar ndaj konferencës për medie të mbajtur të dielën nga kryeministri Albin Kurti dhe



## Konjufca: Vettingu do ta forcojë sistemin e drejtësisë në Kosovë

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, pas pranimit të dosjes për vettingun në drejtësi nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se ky proces do ta forcojë sistemin e drejtësisë në vend. “Sot e pata kënaqësinë t’i takoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti dhe ministren e Drejtësisë, znj.

Albulena Haxhiu, të cilët e dorëzuan në Kuvend dosjen me dokumentet përkatëse për procesin e vettingut në sistemin e drejtësisë. Procesi gjithëpërfshirës i vettingut, siç e kemi theksuar njëzëri, është një reformë e domosdoshme për sundimin e ligjit. Kjo është, po ashtu, një kërkesë shoqërore e kamotshme për Kosovën. Krijimi, votimi dhe implementimi i tij është një

hap jetik për mbarëvajtjen e shtetit dhe njëra nga reformat më të rëndësishme në sistemin e drejtësisë që e ngrit efikasitetin dhe profesionalizmin. Si i tillë, procesi i vettingut do ta forcojë sistemin e drejtësisë, i cili ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës”, ka shkruar Konjufca në “Facebook”.

ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. Në reagimin e përbashkët të KPK-së dhe Prokurori i Shtetit kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me, siç kanë deklaruar, riciklimin e vazhdueshëm të deklarave të pamatura, të paverifikuara dhe deklarimin e pasaktë të raporteve zyrtare dhe të dhënave statistikore lidhur me sistemin prokurorial. “Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit shprehin sërish shqetësimin e thellë lidhur me riciklimin e vazhdueshëm të deklarave të pamatura, të paverifikuara dhe deklarimin e pasaktë të raporteve zyrtare dhe të dhënave statistikore në raport me sistemin prokurorial, i cili po bëhet vetëm për konsum dhe agjendë politike nga ana e kryeministrin të Qeverisë së Republikës së Kosovës”, është thënë në reagimin e KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit. Sipas tyre, kjo po bëhet për konsum dhe agjendë politike nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. “Faktikisht, këto

prononcime publike të kryeministrin dhe ministres së Drejtësisë për parashkrimin e rasteve të dhunës seksuale në prokurori, demantohen tërësisht nga raportet zyrtare të sistemit prokurorial. Nga raportet e KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, sipas të dhënave për veprat penale për rastet e dhunës seksuale përgjatë vitit 2020, 2021 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, është parashkruar vetëm një (1) rast që ka pasur të bëjë me dhunën seksuale. Në këtë rast theksojmë se informacionet e deklaruarat sot nga kryeministri janë të pasakta, nuk kanë të bëjnë asgjë me realitetin dhe janë krejtësisht tendencioze për sistemin prokurorial. KPK-ja dhe Prokurori i Shtetit ia bëjnë me dije kryeministrin dhe qeverisë se statistikën zyrtare nuk hartohen me paragjykim, por verifikohen, analizohen me profesionalizëm dhe miratohen në takimet e hapura për publikun nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Për më

tepër, ky deklarim i pasaktë dhe tendencioz i kryeministrin shpreh nevojën që kryeministri i vendit të bashkëpunojë dhe bashkëveprojë me sistemin prokurorial në suaza të kompetencave përkatëse, duke respektuar normat dhe standardet e funksionimit demokratik të institucioneve në Republikën e Kosovës”, është thënë në këtë reagim.

Qeveria e Kosovës më 13 tetor kishte miratuar koncept-dokumentin për vettingun në drejtësi përmes të cilit synohet të forcohet sundimi i ligjit. Vettingu me ndryshime kushtetuese kërkon dy të tretat e votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës më herët kishin thënë se Kosovës i duhet vetting sistematik në drejtësi. Ndërsa Komisioni Evropian kishte kritikuar planin e Qeverisë së Kosovës për të bërë vetting “të njëhershëm të të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve”, duke thënë se ky do të ishte “burim serioz i shqetësimit”.

## Bërnabiqi sot vjen në Kosovë, Bislimi e Nagavci shkojnë në Luginë

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, do ta vizitojë sot (e hënën) Republikën e Kosovës. Sipas njofimit që e ka bërë e

ashtuquajtura Zyrë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Bërnabiqi do të realizojë një vizitë njëditore në komunat veriore të Kosovës, përkatësisht

në Mitrovicën e Veriut, Zveçan dhe Leposaviq. Me këtë rast kryeministri i Kosovës ka thënë se Kurti pret nga Bërnabiqi të mos japë deklarata përçarëse.

Ndërsa sot (e hënën) Luginën e Preshevës do ta vizitojnë zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi dhe ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci.



## Osmani: Jam krenare me shembullin që la pas Nënë Tereza

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Krerët e shtetit në 25-vjetorin e kalimit të Nënë Terezës në amshim dhe në gjashtëvjetorin e shenjtërimit të saj nga Papa Françesku kanë vizituar motrat e Nënë Terezë në Pejë.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se ndihma e këtyre motrave shkon edhe përtej mureve. Ai i ka falënderuar ato për punën e tyre që bëjnë vazhdimisht. "Ndihma e tyre shkon edhe shumë përtej mureve të kësaj ndërtese, sepse vizitojnë edhe shumë familje këtu në Pejë, familje që kanë nevojë dhe këtë shërbim, këtë

mision, janë duke e kryer në 30 vjetët e fundit apo edhe më shumë. Motrat e Nënë Terezë vijnë nga vende të ndryshme të botës. Ndihe mi krenare me shembullin që la pas Shën Tereza e cila doli nga populli shqiptar, por u bë nëna e të gjithëve me ndihmën që dha", ka thënë ajo.

Ndërsa kryeministri i vendit, Albin Kurti, është shprehur krenar me punën e Nënë Terezë, derisa ka thënë se ajo është ideal që duhet ndjekur secili. "Me rastin e gjashtëvjetorit të shenjtërimit të Nënë Terezë, e cila me punën e saj të

pamatshme, me sakrificën e saj të jashtëzakonshme, me dashurinë e saj të pakrahueshme, duke mos kërkuar as shpëtim e as shpërblim, u bë nëna e gjithë botës dhe na shtoi krenarinë neve si popull, si komb prej gjirit të së cilës doli ajo. Sot e përkujtojmë Nënë Terezë jo vetëm për angazhimin sakrifikes të saj, por edhe si ideal që duhet të ndjekim secili prej nesh, kur duam t'i shërbejmë popullit dhe qytetarëve", ka thënë Kurti.

Në anën tjetër, ipeshkivi imzot Dodë Gjergji i ka urrear të gjithë



besimtarët katolikë me rastin e 6-vjetorit të shenjtërimit të Nënë Terezës. "Unë e falënderoj Zotin që ia kemi dhënë një vajzë dhe na ka kthyer një nënë e ajo na ka dhënë katër motra për ta

zëvendësuar vetveten këtu që punojnë në mesin tonë", ka thënë ai.

Festa e Shën Nënë Terezës do të kremtohet sot (e hënë) me disa aktivitete.

## Haradinaj takon Jasharaj: Ka vetëm një zgjidhje, rritja e pagave



Pas zhvillimeve të shumta në vend, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka takuar të dielën kryetarin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rahman Jasharaj. Pas këtij takimi, Haradinaj ka thënë se ka vetëm një zgjidhje, e që është rritja e pagave. "Bisedë e sinqertë me kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj. Ka vetëm një

zgjidhje: rritja e pagave. Qeveria të procedojë sa më parë Ligjin e Pagave. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës mbështet kërkesat e drejta të sindikatave në mbarë vendin", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ndërsa kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, ka bërë me dije se greva e mësimdhënësve do të vazhdojë deri në realizimin e kërkesave të tyre.

"Ne i kemi bërë të ditura kërkesat tona. 100 euro shtesë deri në miratimin e Ligjit të Pagave. 50 eurot e ofruara nga qeveria konsiderojmë se nuk i mbulojnë kërkesat tona. Ne e përgëzojmë qeverinë për pakon e miratuar, por ajo nuk i plotëson kërkesat tona. Ligji i Pagave po vonohet, ndërsa ju po e shihni se çmimet po rriten çdo ditë", ka thënë Jasharaj.

## Kryetarët e komunave të udhëhequra nga LV-ja kërkojnë ndërprerjen e grevës

Prishtinë, 4 shtator (ER) - Kryetari i Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka bërë me dije që së bashku me kryetarin e Gjilanit, Alban Hyseni, kryetarin e Kamenicës, Kadri Rahimaj dhe kryetarin e Shtimes, Qemajl Aliu, kanë paraqitur shqetësimet e tyre lidhur me mosfillimin e vitit të ri shkollor në nivel vendi. Ai ka thënë se kanë kërkuar nga prindërit që t'i dërgojnë

fëmijët në shkolla dhe të ndërpritet greva. "Nga kjo konferencë ne u bëmë thirrje prindërve që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla dhe apeluam te mësimdhënësit që të jenë pjesë e procesit mësimor duke e ndaluar grevën. Qeveria e Kosovës tashmë ka vendosur në diskutim publik Ligjin për Paga, ku mësimdhënësit trajtohen me paga të

dinjitetshme si dhe është përkujdesur me pakon e re mbështetëse në ndihmë të qytetarëve karshi inflacionit", ka njoftuar Bulliqi, i cili së bashku me tre kryetarët e tjerë vijnë nga radhët e Vetëvendosjes. Edhe Ministria e Arsimit të dielën ka kërkuar nga mësimdhënësit që sot (e hënë) të kthehen në shkollë dhe ta ndërpresin grevën.



## Kurti në "Hardh Fest" rithekson mbështetjen për prodhimet vendore



Rahovec, 4 shtator - Në ditën përmbyllëse të festës së vjeljes së rrushit, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, kanë vizituar Festivalin "Hardh Fest".

Duke rithekson mbështetjen e qeverisë për prodhimet vendore, kryeministri Kurti ka përgëzuar organizatorët për përkushtimin e tyre për organizimin e festivalit si dhe promovimin e kulturës së

rrushit. Edicioni i 20-të i këtij festivali përgjatë tri ditësh ofroi program të pasur artistik dhe kulturor. "I organizuar në vreshtat e Rahovecit, 'Hardh Fest' solli rrush të shijshëm, aktivitete

rekreative, vizita në vreshta, muzikë e poezi. Nën sloganin 'Ca kokrra rrushi', edicioni i sivjetmë i 'Hardh Fest' iu dedikua poetit të ndjerë Xhevdet Bajraj", thuhet në komunikatën për medie.

## Krasniqi në "Hardh Fest": Rahoveci, pikëtakim i dashmirëve të verës dhe muzikës

Rahovec, 4 shtator (ER) - Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka qëndruar në Rahovec, ku në kuadër të festivalit "Hardh Fest" ka

takuar vreshtarët e kësaj komune. Krasniqi, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka thënë se ka qëndruar në shoqërinë e

miqve e dashmirëve dhe ka bashkëbiseduar me qytetarë të shumtë nga e tërë Kosova. "Në qytetin e rrushit, vreshtave e verërave – në

Rahovec, në një atmosferë miqësore e mikpritëse, u mblodhëm për 'ca kokrra rrushi' në 'Hardh Fest', ka shkruar Krasniqi.



# Rama për 'Der Spiegel'-in: Vendimi për pavarësinë e Kosovës ishte i duhuri

**TIRANË, 4 SHTATOR** - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është duke bërë përpjekje të provojë një akt të vështirë balancues. Ai është duke dëshiruar ta integrojë Ballkanin Perëndimor dhe ta garantojë Kosovën si shtet të pavarur, në të njëjtën kohë t'i shërojë dhimbjet fantazmë të Serbisë. Kështu ka shkruar gazeta e njohur gjermane "Der Spiegel", duke shtuar se Rusia është duke nxitur konfliktin në Ballkan dhe është duke rrezikuar paqen e brishtë. Sipas Ramës, vendimi për pavarësinë e Kosovës ishte i duhuri. "Putini thotë: Kosovë, Kosovë, Kosovë. Rusia po nxit konfliktin në Ballkan dhe po rrezikon paqen e brishtë", ka thënë Rama.

## Shkrimi i plotë i "Der Spiegel"-it

Putini thotë: Kosovë, Kosovë, Kosovë. Rusia po nxit konfliktin në Ballkan dhe po rrezikon paqen e brishtë. Kryeministri Edi Rama shpjegon se çfarë ndihmon kundër mosbesimit dhe urrejtjes dhe çfarë lidhje ka Angela Merkel me të. Kryeministri pret të ftuarit zbatuar. Edi Rama është një burrë shtatlartë me një vetull të gërvishur dhe me sy të thellë. Veshur me pantallona të shkurtra e të zeza, një bluzë të bardhë Adidas dhe pa këpucë, Rama ulet me gruan e tij, Lindën në kopshtin e një shtëpie në plazh. Vila e viteve 1960 ndodhet pranë fshatit bregdetar të Dhërmiut, e rrethuar nga pisha. Dikur shteti e ndërtoi për diktatorin shqiptar Enver Hoxha. Oficerët e policisë qëndrojnë roje te dera. Njeriu më i fuqishëm në Shqipëri është me pushime. "Nuk më shqetësoni", u thotë Linda Rama gazetareve të "Der Spiegel"-it, e cila ka veshur një këmishë të bardhë pambuku dhe një kapele me majë mbi flokët e saj kaçurrela të zeza. Në pozicionin që është bashkëshorti i saj, nuk ka pushime të vërteta. Njëmbëdhjetë vjet më parë, shqiptarët zgjodhën për herë të parë kryeministër Edi Ramën me një shumicë të madhe votash. Si kryetar i bashkisë së Tiranës, rrugët ishin të lyera me ngjyra të ndezura ndërsa i shpalli luftë gjyqësorit të korruptuar. Sot kritikët akuzojnë Ramën se mban kontakte me të inkrimuar, gjë që ai e ka mohuar. Dhe korrupsioni nuk është aspak problemi i vetëm i Shqipërisë. Lufta në Ukrainë, vetëm rreth një mijë kilometra larg, po rihap plagët e vjetra në rajon. Fuqitë e mëdha po tërheqin sërish Ballkanin Perëndimor tashmë të brishtë. Muajt e fundit janë intensifikuar sërish tensionet mes Serbisë dhe Kosovës e cila është e lidhur ngushtë me Shqipërinë. Në rrezik nuk është asgjë tjetër përveç paqes në Ballkan. Ashtu si Ukraina, Serbia kërcënon të bëhet mollë shëri mes Rusisë dhe Perëndimit: vendi po përpqet të bashkohet me BE-në, por nuk mund të shkëputet nga Rusia aleate. Ndërsa Putini po mbyll furnizimet me gaz në Evropë, Rusia po e furnizon Beogradin me energji dhe me armë. Çmimi për këtë



është besnikëria, një kërkesë që e copëton Serbinë. "Askush nuk do të shkatërrojë marrëdhëniet tona me Serbinë", tha ministri i Jashtëm rus Sergej Lavrov kohët e fundit kur vizita e tij e planifikuar në Beograd u anulua në një njoftim të shkurtër për shkak të një urdhër ndalim për të udhëtuar. U duk si një kërcënim. Rusia nuk e fsheh dot dëshirën e saj për të frenuar ndikimin e ShBA-së në Ballkanin Perëndimor.

Deti ngjyrë turkeze shkëlqen pas Ramës dhe skeletit e betonit të hoteleve luksoze gjysmë të përfunduara ngrihen nga kodrat e gjirit të Dhërmiut. Këtu do të hapen së shpejti disa hotele me pesë yje. Është e vështirë të imagjinohet se dy dekada më parë Shqipëria ishte ende në prag të luftës civile, kur vendi po luftonte me bandat, milicët dhe grupet lokale vigjilente pas rënies së sistemit komunist. Sot shteti i ri mbështetet në industrinë e turizmit.

Shqipëria është më e vogël se Brandenburg dhe me vetëm 2.8 milionë banorë. Këtu jetojnë më pak banorë sesa në Berlin. Megjithatë, vendi në Ballkanin Perëndimor është i rëndësishëm për mbrojtjen strategjike, edhe kundër manovrave të mundshme përçarëse nga Moskë. Anëtare e NATO-s që nga viti 2009, duke u përpjekur për t'u anëtarësuar në BE, Tirana vepron si një lloj kundërpeshë ndaj Serbisë.

Pak para sulmit rus ndaj Ukrainës, NATO sapo kishte filluar të shndërronte një aeroport të vjetër në jug të Shqipërisë në një bazë të forcave ajrore. Qeveria e Ramës i ofroi gjithashtu aleancës transatlantike për të ndërtuar në të ardhmen një bazë detare të NATO-s pranë qytetit port të Durrësit. Nëse do të kishte konflikte mes serbëve dhe shqiptarëve në të ardhmen, për shembull në veri të Kosovës, Tirana ndoshta do të luante një rol qendror.

Rama shpjegon se banorët në rajon ndahen në ata që kundërshtojnë Putinin dhe ata që

e mbështesin atë. Dhe ai beson se, "Rusia do të ishte e kënaqur nëse diçka do të lëvizte në drejtim të konfliktit në Ballkan". "80 për qind e serbëve ortodoksë mendojnë pozitivisht se Putini thjesht po i tregon Perëndimit topat në Ukrainë... nëse mund ta themi kështu", thotë kryeministri Rama. Tensionet e reja në Ballkan po ecin thuasje përgjatë linjave të vjetra të ndikimit sovjetik dhe perëndimor. Në Shqipëri, nga ana tjetër, miratimi për veprimet e Putinit ishte vetëm 0.7 për qind. Qeveria e tij i zbuloi numrat me anë të një sondazhi.

Rama beson se simpatitë për Moskën janë "të forta" në Serbi, madje "shumë të forta" në Republikën Srpska, ku jetojnë shumica e serbëve të Bosnje e Hercegovinës. Në Mal të Zi, nga ana tjetër, ka një përçarje të thellë mes popullatës malazeze dhe serbe. "Duhet të jemi të vetëdijshëm se ky ndikim mund të kthehet në diçka të tmerrshme", shton ai.

Edhe 23 vjet pasi trupat e NATO-s ndërhyjnë në Kosovë, rajoni ende kontrollon nga aleanca ushtarake perëndimore. Në vitin 2008, Kosova më në fund shpalli pavarësinë e saj. Mosmarrëveshja me Serbinë nuk është zgjidhur asnjëherë politikisht. Humbja e krahinës e populluar kryesisht me shqiptarë, prek edhe sot Beogradin. Për shumë serbë, pra, pagja ka mbetur e zbatuar edhe sot e kësaj dite. Për të ndaluar vrasjen e mijëra shqiptarëve dhe shpërnguljen e qindra mijëra njerëzve në vitin 1999, aleanca e NATO-s theu rregullat e veta. Sulmi ndaj Serbisë, bombardimi i Beogradit, nuk u mbulua nga asnjë mandat i OKB-së. Politikanët në Washington dhe Berlin e justifikuan masën si një "përpjekje humanitare". Gati njëqind vende e kanë njohur tani Kosovën. Megjithatë, Rusia, Kina dhe disa vende të BE-së, përfshirë Spanjën dhe Greqinë, nuk e kanë njohur atë. Mund të thuhet gjithashtu se misioni i NATO-s në Kosovë, shërben si një lloj justifikimi për politikën agresive të

aneksimit të Putinit në Krime, Donetsk, Luhansk, Abkhazi dhe Gjeorgji. Ndoshta ishte fillimi i krizës së sotme. A mund të përsëritet katastrofa e luftërave jugosllave?

Rama i përgjigjet me një kundërpjetje se "A keni dëgjuar sa herë Putini përmend Kosovën në fjalimet e tij?". "Përsërit vazhdimisht Kosovë, Kosovë, Kosovë. Shefi i Kremlinit nxit "problemet më të dhimbshme nga të gjitha të pazgjidhurat" në Ballkan dhe bën gjithçka për të krijuar një fitil të ri. Rama e sheh vendin e tij të ankoruar fort në Perëndim. Si pak politikanë në rajon, ai ka kapur botën e interesave të ndryshme dhe kultivon ato ndërkombëtare. Kontaktet, nga Riadi në Stamboll, Paris dhe Uashington. "Kur Hillary Clinton telefonoi një vit më parë dhe kërkoi të merrja disa mijëra refugjatë afganë pa dokumente, përgjigjja ishte menjëherë po", theksoi Rama.

Për shkak të mbështetjes në luftën e Kosovës në vitin 1999, Rama nuk do ta refuzonte kurrë një dëshirë të Clintonit. Në fund të shekullit, profesor në akademinë e artit të Tiranës dhe djali i një skulptori të njohur, i lidhur me lëvizjen për demokraci nuk kishte shumë si ai në atë kohë: atlet i mirë, artist i lirë, folës frymëzues.

Por në luftën e Ramës për njohjen e një Kosove të vetëvendosur, tonet nacionaliste shqiptare ndonjëherë ngatërrohen. Kur Rama udhëheq mbledhje të përbashkët të Prishtinës dhe Tiranës, kjo i shkakton Beogradit atë që i frikësohet, krijimit të "Shqipërisë së Madhe". Rama u rrit në një vend të izoluar. Për dekada Shqipëria u konsiderua si Koreja e Veriut në Evropë.

Bazuar në këtë përvojë, 58-vjeçari po provon njërë ekuilibër të vështirë: ai dëshiron të integrojë Ballkanin Perëndimor dhe të garantojë Kosovën si shtet të pavarur, por në të njëjtën kohë të shërojë dhimbjet fantazmë të Serbisë. "Vendimi për pavarësinë e Kosovës ishte i duhuri! Në fund të fundit, tani ka edhe një 'proces

paqeje dhe pajtimi' edhe nëse do të vazhdojë për një kohë të gjatë", thotë Rama duke shtrirë duart në ajrin e ngrohtë të verës.

Pas zgjedhjes së tij në 2013, Rama udhëtoi për në Beograd, vizita e parë e një kreu të qeverisë së Tiranës në 68 vjet. Kur Rama i kërkoi qeverisë serbe që të njhihe Kosovën, homologu i tij serb Vuçiq e mori mënjandë dhe tha se "stafi i tij po e kërkonte që të dëbonte mikpritësin e guximshëm". Sipas Ramës, ai i është përgjigjur Vuçiqit se këta ishin thjesht zyrtarë të tij, por ai ishte më i zgjuar dhe për rrjedhojë, kreu i qeverisë. "Megjithatë, kohët e fundit ka pasur edhe zhvillime inkurajuese në Ballkan. Kështu që unë dua që Serbia, Shqipëria dhe Mali i Zi të krijojnë një lloj mini-zone Shengen për të bërë shkëmbime më të mira", tha Rama.

Projekti "Ballkani i hapur" e bashkon atë me "armikun e tij më të dashur Aleksandar Vuçiq". Premtimi për lirinë e lëvizjes ndërmjet vendeve është një ndjesi e vogël.

Në përfundim të vizitës, Rama thotë se në fakt e gjitha ka qenë ideja e Angela Merkelit. Përmes saj, ai dhe Vuçiqi gjetën një marrëdhënie të qëndrueshme pune, "pavarësisht historisë së dhimbshme". Në vitin 2014, kancelarja ftoi gjashtë krerët e qeverive të Ballkanit Perëndimor në Gjermani, të cilën e quajti "Procesi i Berlinit". Merkel tha se "ishim evropianë, edhe pse jo ende anëtarë të Bashkimit Evropian". "Për herë të parë në historinë e Ballkanit, politikanë të lartë u ulën së bashku në një tryezë një herë në vit, gjithmonë në qytete të ndryshme evropiane, në Londër, Paris, Trieste, Vjenë. Deri sa u largua nga politika, Merkel ishte personalisht çdo herë e pranishme. Kjo ka ndryshuar gjithçka", thotë kryeministri shqiptar. Në këto bisedime, gjashtë liderët e vendeve të Ballkanit ranë dakord të mos pajtohen. Por të gjithë kishin një vullnet të përbashkët, thotë Edi Rama se "Të përmbysnin fatin e historisë".

## Kryetari i OEK-ut: Bizneset po ballafaqohen me sfida të shumta

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, ka thënë se, pavarësisht prej krizës, nuk ka indikacione që ndonjë investitor i huaj ka shprehur frikën të largohet nga Kosova. Por, sipas tij, duhet të hiqen të gjitha barrierat dhe të hapet një kanal më i thjeshtë i komunikimit me investitorë të huaj. “Nuk kam indikacion që ndonjë investitor i huaj ka shprehur frikë të ikë nga Kosova, por duhet të punojmë të thithim investime të tjera, duke përfshirë Odën Ekonomike dhe qeverinë, që të hiqen të gjitha ato barrierat dhe të hapet një kanal më i thjeshtë i komunikimit me investitorë të huaj”, ka thënë ai.

Rafuna ka thënë se për ta ndihmuar qytetarin dhe

biznesin qeveria duhet të ofrojë mundësi më të mira buxhetore. Sipas tij, të gjitha institucionet do të duhej të diskutonin për gjetjen e një zgjidhjeje në këtë fazë, duke konsideruar si mundësi edhe pezullimin e tatimit dhe të akcizës, apo edhe subvencionimin e bizneseve. “Gjithmonë për ta ndihmuar biznesin dhe qytetarin duhet që Qeveria e Kosovës të shohë se cilat janë mundësitë më të mira buxhetore. A është më mirë të intervenohet me të hyrat duke pezulluar për një kohë të caktuar qoftë tatimin e akcizës e doganor, apo ta shohë që të intervenohet duke subvencionuar bizneset. Më e mira do të ishte që ne të gjithë të ulemi dhe të shohim se cila është mundësia më e mirë



nëpërmjet intervenimit të të hyrave në kuptim të marrjes së të hyrave për lirim apo reduktim të ndonjë tatimi apo te shpenzimet nëpërmjet subvencionit që i ofron qeveria”,

ka thënë Rafuna për “EO”. Ai ka thënë se prodhuesit po ballafaqohen me sfida të mëdha e tash edhe nga reduktimet e energjisë elektrike, andaj Rafuna thotë se duhet të

paralajmërohen me kohë në mënyrë që të ketë pasoja më të vogla. “Prodhuesit pa dyshim që kanë sfida shumë të mëdha nga reduktimi i energjisë elektrike për arsye se janë të detyruar që të aktivizojnë gjeneratorë ose të gjejnë rrugë alternative për të siguruar energji, e kam fjalën nëpërmjet gazit apo lëndëve të tjera që ndihmojnë procesin e prodhimit. Shumë pajisje të prodhimit nuk mund t'i aktivizojnë nëpërmjet gjeneratorëve. Subjektet prodhuese, nëse nuk ka asnjë mundësi që të kenë energji elektrike me rregull, të jenë të paralajmëruar për orarin e reduktimeve për arsye se ajo lëndë e parë prishet dhe nuk mund të hyjë në funksion”, ka thënë Rafuna.

## Ministri Peci: Fermeri në Kosovë është më i përkrahuri në rajon

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka mohuar se qeveria Kurti është duke ofruar përkrahje më të madhe për komunat që udhëhiqen nga partia në pushtet. “Absolutisht (përkrahja) është e njëjtë për të gjitha komunat. Mund të ndaj me ju një shembull. Në kuadër të investimeve kapitale për kategorinë e investimeve në sektorin e ujitjes, ne kemi nënshkruar memorandume me tetë komuna, prej tyre dy komuna që u është ofruar përkrahja janë nga Vetëvendosje, dy janë nga



LDK-ja, dy nga PDK-ja dhe dy nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Përkrahja ka qenë edhe në aspektin e përfaqësimit të rajoneve të Kosovës, por edhe në aspektin

e përfaqësimit politik, kështu që ne nuk njohim as parti politike në nivel të komunikimit me fermerët, me komunat në proces të realizimit të investimeve”, ka thënë ministri i Bujqësisë. Ai ka thënë se Ministrinë e Bujqësisë e ka gjetur në një situatë të palakmueshme, ndërsa ka shtuar se nga fillimi i punës kjo ministri ka punuar më shumë se të gjitha mandatet e kaluara. “Fatkeqësisht gjendja në të cilën e kam marrë Ministrinë e Bujqësisë ka qenë në një situatë tejte të palakmueshme, vetëm në një kategori borxhet

ndaj fermerëve kanë qenë 40 milionë euro, kështu që e kemi ndryshuar tërësisht këtë pjesë të mënyrës së menaxhimit dhe qasjes në Ministrinë e Bujqësisë, për 1 vit e gjysmë të udhëheqjes së Ministrisë së Bujqësisë nga unë, në këtë rast nga Qeveria Kurti 2, në rast se i marrim për bazë politikat e hartuara, dokumentet strategjike, avancimin e legjislacionit dhe përkrahjen financiare, janë më shumë sesa krejt mandatet e tjera paraprakisht”, ka thënë ai, duke shtuar se fermeri i Kosovës është më i përkrahur në rajon. “Përkrahja jonë në

kategorinë e subvencioneve shkon deri në 216 për qind. Është rritje enorme dhe shumëfishim në të gjitha kategoritë e përkrahjes për fermerët. Është përkrahja më e madhe në rajon. Është përkrahja më e madhe ndonjëherë e realizuar në sektorin e bujqësisë. Tash ne nuk mundemi si institucione ose si vend i vogël të ndikojmë në nivelin e çmimeve të naftës ose të trendit të produkteve ose imputeve bujqësore që kryesisht kanë ardhur si rezultat i krizës energjetike, efektit të pandemisë dhe luftës në Ukrainë”, ka thënë Peci.

## ASK-ja: Rriten çmimet e importit në Kosovë

PRISHTINË, 4 SHTATOR - Indeksi i Tërësishtëm i Çmimeve të Importit në Kosovë ka pësuar ngritje për 4.6 për qind në tremujorin e dytë të vitit 2022 (TM2 2022) krahasuar me TM1 të vitit 2022. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), krahasuar me TM2 të vitit 2021, çmimet e importit kanë pësuar ngritje në një mesatare prej 23.3-përqindësh. Çmimet e importit në Kosovë kanë pësuar ngritje në një mesatare prej 4.6-përqindësh në TM2 2022 krahasuar me TM1 2022. Ngritja më e madhe e çmimeve sipas sektorëve ishte te produktet minerale (16.2 për qind), vajrat ushqyese (13.6 për qind), plastika, kauçuku dhe

artikujt e tyre (7.7 për qind), artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (6.8 për qind), druri dhe artikujt e tij (4.2 për qind), produktet bimore (3 për qind), pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (2.8 për qind), shtazët e gjalla; produktet e shtazëve (2.7 për qind), metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (2.6 për qind), këpucët (2.4 për qind), produktet e industrive kimike (1.6 për qind), letrat dhe artikujt e saj (1.3 për qind), mjetet e transportit (1.2 për qind), tekstili dhe artikujt e tekstilit (0.9 për qind), artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (0.8 për qind) dhe artikujt e ndryshëm të

prodhuar (0.3 për qind). Ngritja është neutralizuar kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve të lëkura dhe artikujt e saj (-3.1 për qind) dhe instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinave, muzikorë dhe mekanizmat e orës (-0.6 për qind). Çmimet e importit në Kosovë kanë pësuar ngritje në një mesatare prej 23.3-përqindësh në mes të TM2 2022 dhe TM2 2021. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te produktet minerale (46.3 për qind), metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (46.2 për qind), artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (34.6 për qind), druri dhe artikujt e tij



(27.7 për qind), vajrat ushqyese (21.3 për qind), produktet bimore (16.0 për qind), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (10.2 për qind), shtazët e gjalla; produktet e shtazëve (9.4 për qind), mjetet e transportit (8.6 për qind), tekstili dhe artikujt e tekstilit (7.0 për qind),

pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (6.7 për qind), instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës (5.8 për qind), artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhan (5.4 për qind), artikujt e ndryshëm të prodhuar (3.1 për qind), produktet e industrive kimike (2.7 për qind) dhe këpucët (0.6 për qind). “Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve lëkura dhe artikujt e saj (-5.9 për qind) dhe te letrat dhe artikujt e saj (-0.1 për qind)”, është thënë në njoftimin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).

## Dogana ndalon 450 litra vaj hidraulik të kontrabanduar nga Irani

PRISHTINË, 4 SHTATOR (ER) - Dogana e Kosovës ka njoftuar se ka ndaluar vaj hidraulik të kontrabanduar nga Irani.

Sipas njoftimit, sasia e mallit është 450 litra. “Në regionin e Prishtinës njësitet e doganës kanë identifikuar dhe

ndaluar një automjet transportues të dyshimtë i cili ishte duke transportuar 450 litra vaj hidraulik me origjinë

nga Irani e që është kontrabanduar në Kosovë”, ka njoftuar Dogana e Kosovës.





# Kërcënimi i një katastrofe të mundshme bërthamore

KIEV, 4 SHTATOR - Në një vend, ku kujtimet e katastrofës bërthamore të Çernobilit janë ende të gjalla, frika nga një tjetër fatkeqësi e ngjashme duket se është normale. Qytetarët në Zaporizhja, qytet në juglindje të Ukrainës, ku ndodhet centrali më i madh bërthamor në Evropë janë shprehur të tmerruar nga luftimet dhe granatimet në dhe përreth kompleksit bërthamor. “Sigurisht që kam frikë. Të gjithë janë të frikësuar. Nuk e dimë se çfarë do të ndodhë, çfarë na pret çdo minutë, çdo sekondë”, ka thënë Maria Varakina, banore e Zaporizhjes.

Nga frika e ndonjë incidenti të mundshëm bërthamor, autoritetet në Zaporizhja u kanë shpërndarë banorëve tableta jodi - medikamente që mbrojnë, deri në një masë, nga substancat radioaktive. “Duke qenë se qarku ynë ndodhet 50 kilometra larg termocentralit bërthamor në Enerhodar - një zonë që mund të ekspozohet ndaj rrezatimit - ne po shpërndajmë tableta jodi, kryesisht për njerëzit nën 40 vjeç. Atyre që janë mbi 40 vjeç nuk u rekomandohen këto pilula”, ka thënë mjekja Lilia Kolesnik për agjencinë e lajmeve “Reuters”.

Centrali bërthamor i Zaporizhjes është ndër dhjetë më të mëdhatë në botë. Ai gjeneron rreth 6.000 megavate rrymë, të mjaftueshme për rreth 4 milionë shtëpi. Gjendet rreth 550 kilometra në juglindje të kryeqytetit të Ukrainës, Kiev. Rusia ka marrë kontrollin e tij në fillim të luftës së saj, por centrali vazhdon të operohet nga stafi ukrainas. Javëve të fundit, dy vendet kanë akuzuar njëra-tjetrën për sulme në dhe pranë centralit. Të dyja pretendojnë se tjetra po planifikon provokime. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka thënë se sulmet ruse kanë shkaktuar ndërprerje disaorëshe të rrymës në central, më 25 gusht. “Çdo minutë që ushtria ruse qëndron në centralin bërthamor, është rrezik për katastrofë globale nga rrezatimi”, ka thënë Zelensky. Rusia i ka mohuar këto pretendime. “Regjimi i Kievit vazhdon aktet e terrorizmit bërthamor në centralin bërthamor të Zaporizhjes. Gjatë 24 orëve të fundit, artileria e forcave të armatosura ukrainase ka granatuar uzinën tri herë”, ka thënë zëdhënësi i Ministrisë ruse të Mbrojtjes, Igor Konashenkov, më 27 gusht. Ankthi më i madh është për atë që mund të ndodhë nëse centrali sulmohet me raketa ose predha artilerie?! Agjencia Ndërkombëtare për Energji Bërthamore ka bërë thirrje për përmbajtje maksimale, duke thënë se granatimet rreth centralit bërthamor mund të çojnë në “katastrofë bërthamore”. Agjencia ka dërguar një ekip inspektorësh atje për të vlerësuar situatën.



MV Ramana, profesor në Shkollën e Politikave Publike dhe Çështjeve Globale të Universitetit të Kolumbisë Britanike, ka thënë për programin “Expose” se, teorikisht, janë tre skenarë që mund të shkaktojnë rrjedhje të materialit radioaktiv nga Zaporizhja. I pari do të ndodhte në rast të sulmit të drejtpërdrejtë mbi reaktorët e tij; i dyti, në rast të dëmtimit të pishinave ku mbledhet karburanti i shpenzuar, që është radioaktiv, dhe i treti në rast se centrali mbetet pa rrymë. “Zaporizhja është një nga centralet më të mëdha bërthamore dhe i pari që bëhet shënjestër e një sulmi të drejtpërdrejtë ushtarak. Më herët, ushtria e Izraelit ka shkatërruar reaktorin bërthamor Osirak në Irak, por ai ka qenë shumë më i vogël dhe nuk ka qenë funksional si Zaporizhja. Zaporizhja ka sasi shumë më të madhe të asaj që ne quajmë inventar radioaktiv. Nëse ky inventar radioaktiv përhapet në atmosferë, atëherë mund të kemi situatë mjaft katastrofike”, ka thënë profesori Ramana. Në vitin 1986 në Ukrainë ka ndodhur aksidenti më i keq bërthamor në historinë e njerëzimit. Një test sigurie në centralin e Çernobilit ka dalë jashtë kontrollit, duke shkaktuar shpërthim dhe zjarr në njërin prej reaktorëve dhe duke lëshuar sasi të mëdha radioaktiviteti në atmosferë. Qindra mijëra njerëz brenda dhe jashtë Ukrainës kanë qenë të ekspozuar. Gjatë viteve, shkalla e vdekshmërisë mes tyre është rritur, ashtu si edhe shkalla e invaliditetit.

Po, cilat janë gjasat që Zaporizhja të shndërrohet në një Çernobil? Për “Expose”-në është përgjigjur Ross Peel, nga Qendra për Shkencë dhe Studime të Sigurisë

në Kolegjin Mbretëror të Londrës. “Mendoj se nuk ka gjasë që centrali të shpërthejë. Ka shumë masa sigurie dhe struktura mbajtëse përreth, që e parandalojnë një gjë të tillë. Megjithatë, gjërat mund të ndodhin. Nuk them kurrë se është e pamundur. Sepse, sa herë që kemi pasur incidente bërthamore në të kaluarën, aty janë kombinuar disa faktorë që kanë qenë të paparashikueshëm. Askush nuk e ka ditur se ato do të ndodhnin përpara se të ndodhnin”, ka thënë Peel. Centrali në Zaporizhja është ndërtuar në vitet 1980 dhe kjo e bën atë relativisht të ri. Shumë ekspertë pajtohen se centralet moderne bërthamore janë jashtëzakonisht të përforuara. Pas ngjarjeve të 11 Shtatorit në ShBA, centralet bërthamore janë testuar për sulme të mundshme, që kanë përfshirë avionë të mëdhenj, dhe është zbuluar se ato janë kryesisht të sigurta. Peel ka thënë se një rrezik në Zaporizhja, potencialisht më serioz, mund të shfaqet nëse në central ndërpritet rryma - qoftë edhe aksidentalisht. Pa rrymë mund të dështojë sistemi i ftohjes dhe karburanti radioaktiv të shkrihet dhe të rrjedhë. “Për aq kohë sa ka energji elektrike nga jashtë, centrali mund të operojë në mënyrë të sigurt. Nëse energjia ndalet, reaktorët duhet të mbyllen, si masë paraprake për sigurinë. Por, edhe kur mbyllen, ata duhet të ftohen. Në këtë rast, pompat ftohëse do të funksiononin me naftë nga gjeneratorët rezervë. Por, në Zaporizhja, disa burime thonë se gjeneratorët nuk punojnë siç duhet”, ka thënë Peel.

Agjencia për çështje bërthamore e Ukrainës ka thënë se tri nga katër linjat e transmetimit të energjisë elektrike në Zaporizhja,

janë dëmtuar nga raketat. Agjencia ka pranuar se gjeneratorët me naftë nuk do të mund të ofrojnë zgjidhje afatgjate. Shqetësim të ngjashëm për rrymën shpreh edhe profesori MV Ramana. Ai thotë se në Zaporizhja mund të përsëritet skenar i ngjashëm me atë të Fukushimës. Në këtë central të Japonisë, në vitin 2011, një cunami masiv ka ndërprerë furnizimin me rrymë dhe dështimi i sistemeve të ftohjes ka shkaktuar rrjedhje radioaktive. Nëse një incident i tillë apo tjetër ndodh në Zaporizhja, çka pastaj? A përhapet dhe si përhapet ai material radioaktiv? Shpjegon Ramana: “Po, absolutisht. Varet nga era, nga shiu, por edhe nga sasia e materialit radioaktiv që lëshohet në atmosferë. Është vështirë të parashikohet. Ka pasur simulime që njerëzit kanë kryer dhe disa prej tyre kanë treguar përhapje të konsiderueshme të kontaminimit. Por, natyrisht, pjesa më e madhe e ndotjes (radioaktive) do të mbetet në Ukrainë, sepse është më afër centralit”.

Ekspertët kanë thënë se kërcënim në vete paraqet edhe faktori njeri. Sipas tyre, stafi ukrainas në Zaporizhja punon me orar të stërzgatur dhe nën stres prej se forcat ruse kanë marrë kontrollin e centralit në muajin mars. Ka frikë se ata nuk do të jenë në gjendje të reagojnë shpejt, nëse diçka shkon keq në central. “Do të shqetësohesha nëse materialet bërthamore, potencialisht, nxirren nga centrali ose përdoren për armë bërthamore. Por, kjo e fundit nuk besoj se ndodh. Unë më shumë shqetësohem nëse ato nxirren jashtë, për të krijuar një narrativë false, se goja Ukraina do t'i përdorë materialet bërthamore. Rusia ka bërë përpjekje [të krijojë këtë skenar]

qysh para fillimit të këtij konflikti”, ka thënë Ross Peel, nga Qendra për Shkencë dhe Studime të Sigurisë në Kolegjin Mbretëror të Londrës.

Rusia i ka hedhur poshtë këto pretendime, të bëra edhe nga disa zyrtarë perëndimorë. Megjithatë, pak ditë pas nisjes së pushtimit të Ukrainës, presidenti rus, Vladimir Putin, ka urdhëruar vendosjen e forcave të tij bërthamore në gjendje gatishmërie. Një letër e nënshkruar nga dhjetëra punonjës të centralit, në muajin gusht, i ka bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar që të ndalet dhe të mendojë. “Ne mund ta kontrollojmë profesionalisht divizionin bërthamor, por ne jemi të pafuqishëm përballë papërgjegjshmërisë dhe çmendurisë së njerëzve”, thuhej në letër.

Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, i ka kërkuar Rusisë që t'i tërheqë trupat dhe të çmilitarizojë zonën përreth centralit në Zaporizhja. Rusia ka refuzuar, duke thënë se një gjë e tillë do ta bënte centralin edhe më të cenueshëm. Përveç rrjedhjes së mundshme radioaktive, në Ukrainë ka edhe kërcënime të tjera bërthamore.

Doktrina ushtarake ruse e lejon përdorimin e armëve taktike bërthamore, deri në 15 kilotonë - të mjaftueshme për të shkatërruar një stadium futbollit dhe çdo gjë tjetër brenda një perimetri prej 1 deri në 3 kilometra. Por, tash për tash, nuk ka asnjë sugjerim se Rusia do ta përdorë një të tillë. Rusia, po ashtu, posedon numrin më të madh të kokave strategjike bërthamore në botë.

me dije se arsyeja e ndërprerjes ishte një defekt teknik në tubacion, i cili ka të ngjarë ta përkeqësojë krizën energjetike në Evropë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Kosova U20 mposht bindshëm Maqedoninë e Veriut

Prishtinë, 4 shtator - Përfaqësuesja U20 e Kosovës në voleyboll ka mposhtur me rezultat bindës, 3-0 në sete, Maqedoninë e Veriut në ndeshjen që u zhvillua të

dielën pasdite në Gjakovë. Ishte një paraqitje inspiruese nga "Dardanët", e cila sigurisht se do të shërbejë si motiv para Kampionatit Evropian, i cili zhvillohet mes datave 6-10


shtator në Shqipëri. Ekipi i drejtuar nga trajneri Blendi Haxhikadrija nisët nesër drejt Shqipërisë, ku do të kryejë ca sesione stërvitore para ndeshjeve kompetitive.



## Balkani fiton derbin ndaj Prishtinës

PRISHTINË, 4 SHTATOR, 2022 - Kampioni në fuqi, Balkani ka shënuar fitore në derbin e javës së pestë në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll. Portokallezinjtë, të dielën mbrëma në "Fadil Vokrri", fituan si mysafirë ndaj Prishtinës, me rezultat 1:0. Golin e vetëm në ndeshje e shënoi Albion Rrahmani në minutat shtesë të pjesës së parë, me gjuajtje me kokë pas harkimit të Armend Thaçit. Në kaptinën e dytë Prishtina ishte më këmbëngulëse, por nuk arriti ta gjejë rrugën e golit, ndonëse e pati përkrahjen e konsiderueshme të tifozëve. Skuadra e Gjilanit ka realizuar fitoren e katërt në këtë edicion dhe krahas një barazimi kryeson me meritë renditjen e Albi Mall Superligës pas javës së 5-të, me 13 pikë. Skuadra e drejtuar nga Zekirija Ramadani, të dielën, ka shënuar fitore si mysafire ndaj Dukagjinit në stadiumin "18 Qershori" në Klinë,

me rezultat 1:0. Gjilanasit patën paraqitje shumë të mirë në pjesën e parë, ku pasi goditen në dy raste shtyllën, arritën të gjejnë golin e fitores në minutën e 38-të. Solomon e shfrytëzoi siç duhet asistimin e Islamit dhe nga brendësia e zonës shënoi në portën e Muhaxhirit. Ndërkaq, në pjesën e dytë përkundër insistimit të vendasve për të barazuar shifrat, gjilanasit arritën ta menaxhojnë lojën dhe ta mbajnë portën të paprekur. Ndërkaq, ndeshja tjetër e cila u zhvillua në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj, ndërmjet Drenicës dhe Ferizajt nuk prodhoi gola (0:0). Kësisoj, pas pesë xhirove të para Drenica ka 5 pikë, derisa Ferizajt ka arkëtuar vetëm 3 pikë. Të shtunën janë zhvilluar dy ndeshje, ku Drita ka shënuar fitore me rezultat bindës ndaj Llapit (4:0), derisa Malisheva ka arkëtuar tri pikë si mysafire në duel me Trepçën'89 (3:2).



## Uniteti e njofton me humbje Arsenalin



MANCHESTER, 4 SHTATOR - Është mbyllur mes spektaklit sfida kryesore e Premier Ligë mes Manchester United dhe Arsenalit, ku në "Old Trafford" triumfoi skuadra vendase me shifrat 3-1, me "Topçinjtë" që pësojnë humbjen e parë pas 5 fitoresh rresht në kampionat. Një pjesë e parë që dhuroi emocione të vërteta, ndërsa spektakli nisi që në minutat e para kur miqtë do të gjenin golin e avantazhit, por VAR do të bëhej protagonist duke anuluar golin e "Topçinjve". Në këto kushte, ishte radha e vendasve të gjenin epërsinë, ku 100 milionëshi i djajve, Antony do të debutonte me gol në "Teatrin e Ëndrrave". Ish-lojtari i Ajax do të giente golin në minutën e 35-të dhe të gjithë ngrihen në festë.

Arsenal do të barazonte shifrat në pjesën e dytë në minutën e 60-të kur Saka do të ndëshkonte vendasit, por kundërpërgjigjet shpejt United me Marcos Rashford, i cili do të rikthente të tijtë në avantazh. Do të ishte përsëri sulmuesi Rashford që do të gjente edhe golin e dytë personal në minutën e 76-të dhe të tretin për djajtë, duke çuar rezultatin në 3-1, me Arsenalin që tronditet. Në minutat e tjera të takimit nuk do të ndryshonte rezultati me United që siguron kështu fitoren e radhës në Premier Ligë, duke grumbulluar 12 pikë në 6 ndeshje, ndërsa Arsenali i Artetës mbetet në kuotën e 15 pikëve në vendin e parë, ndërsa marrin kështu humbjen e parë në këtë sezon.

## Verstappeni triumfon në vendlindje, 'blindon' vendin e parë

Amsterdam, 4 shtator - Max Verstappen ka dominuar nga fillimi e deri në fund Çmimitin e Madh të Holandës, garën e shtëpisë së tij. Piloti i Red Bullit

u nis nga vendi i parë dhe e ruajti atë deri në fund. Në vendin e dytë u rendit George Russell me Mercedes, ndërsa podiumin e plotësoi Charles

Leclerc me Ferrari. Me këtë triumf të radhës, Verstappen shton dhe më tej diferencën në kryesimin e renditjes së përgjithshme, teksa ka 310 pikë,

ndërsa vendi i dytë mbahet nga Charles Leclerc (Ferrari) dhe Sergio Perez (Red Bull), me 201 pikë secili, 109 më pak se holandezi.





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Në bazë të vendimit të Komisionit të posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, datë 21 korrik 2022, publikohet:

**FTESË / THIRRJE PUBLIKE**

*për*

PARAQITJEN E NOMINIMEVE PËR DY (2) GJYQTARË NË  
GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me nenin 114.1 të Kushtetutës dhe me nenet 4 dhe 6, të Ligjit Nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, fton Kuvendin e Republikës së Kosovës, institucionet gjyqësore, fakultetet juridike, Odën e Avokatëve, Shoqatën e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve, partitë politike, personat e tjerë relevantë juridikë dhe individët, që të propozojnë kandidatë për zgjedhjen e dy (2) gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Po ashtu, një person mund të propozojë veten për kandidat.

Komisioni në mënyrë të veçantë inkurajon gratë për të aplikuar.

**Kualifikimet:**

Kandidatët për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; juristë të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional, me jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë pune profesionale, veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, *mes tjerash*, përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civilë ose mësimdhënës universitarë dhe punë të tjera të rëndësishme të natyrës juridike, individë me reputacion të shkëlqyeshëm moral, të cilët kanë aftësi të plotë veprimi dhe të cilët nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale.

Të gjitha propozimeve dhe aplikacioneve për nominime, duhet t'u bashkëngjiten dokumentet si vijon:

- Formulari për nominimin e kandidatit;
- Formular të deklaramit të të nominuari;
- Curriculum Vitae (C.V) (autobiografia);
- Letra e motivimit nga organizata ose institucioni propozues;
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk janë të dënuar për ndonjë vepër penale.

Nominimet dhe aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më **26 shtator 2022**, në orën **16:00**.

Nominimet dhe aplikacionet dërgohen personalisht në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë - Rr. "Nëna Terezë" p.n. Drejtorja e Personelit, Zyra N-217.

Aplikacionet mund të merren në këto vende:  
Forma e shtypur: Në shërbimin përkatës të administratës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ose forma elektronike: në ueb- faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës – [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Na osnovu odluke Posebne komisije za razmatranje kandidata za imenovanje sudija Ustavnog suda, od 21. jula 2022. godine raspisuje se sledeći:

**POZIV / JAVNI POZIV**

*za*

PRIJAVLJIVANJE NOMINACIJA ZA DVOJE (2) SUDIJA  
USTAVNOG SUDA REPUBLIKE KOSOVO

Posebna komisija za razmatranje kandidata za imenovanje u Ustavnom sudu, u skladu sa članom 114.1 Ustav Republike Kosovo i članovima 4 i 6 Zakona br. 03/L-121 o Ustavnom Sudu Republike Kosovo, poziva Skupštinu Republike Kosovo, pravosudne institucije, pravne fakultete, Advokatsku komoru, Udruženje sudija i tužilaca, političke partije, druga relevantna pravna lica i pojedince da predlože kandidate za izbor dvoje (2) sudija Ustavnog Suda Republike Kosovo. Takođe, jedno lice može da predloži sebe za kandidata.

Komisija posebno podstiče žene da se prijave.

**Kvalifikacije:**

Kandidati za položaj sudije Ustavnog suda mora da budu državljani Republike Kosovo; istaknuti pravници sa odličnom profesionalnom reputacijom, ne kraćom od deset (deset) godina stručnog rada, naročito u oblasti javnog i ustavnog prava, dokazanog, *između ostalog*, putem stručnog rada sudija, tužilaca, advokata, civilnih službenika ili univerzitetskog predavača i drugih značajnih poslova pravne prirode; lica sa odličnom moralnom reputacijom, radno sposobni, koji nisu kažnjavani za krivična dela.

Svim predlozima i aplikacijama za nominacije mora se priložiti sledeća dokumentacija:

- Formular nominacije kandidata
- Formular deklaracije nominiranog,
- Curriculum Vitae (C.V) ("autobiografija"),
- Preporuka organizacije ili institucije koja ga predlaže,
- Dokaz da je građanin Kosova,
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi.
- Dokaz o radnom iskustvu
- Dokaz da nisu kažnjani za krivično delo.

Nominacije i aplikacije treba da se dostave najkasnije do **26. septembra 2022. godine** u **16.00** časova.

Nominacije i aplikacije se lično dostavljaju na adresu:  
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština – ul."Majke Tereze", bb. Direkcija personala, Kancelarija N-217.

Aplikacije se mogu uzeti na sledećim mestima:  
Formular: pri dotičnoj službi administracije Skupštine Republike Kosovo ili elektronskom poštom: web stranica Skupštine Republike Kosova - – [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova na br. telefona 038 211-182, 038 211-648, i 044 567-041.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

Na osnovu odluke Posebne komisije za razmatranje kandidata za imenovanje sudija Ustavnog suda, od 21. jula 2022. godine raspisuje se sledeći:

**POZIV / JAVNI POZIV**

za

**PRIJAVLJIVANJE NOMINACIJA ZA DVOJE (2) SUDIJA  
USTAVNOG SUDA REPUBLIKE KOSOVA**

Posebna komisija za razmatranje kandidata za imenovanje u Ustavnom sudu, u skladu članom 114.1 Ustav Republike Kosovo i članovima 4 i 6 Zakona br. 03/L-121 o Ustavnom Sudu Republike Kosovo, poziva Skupštinu Republike Kosovo, pravosudne institucije, pravne fakultete, Advokatsku komoru, Udruženje sudija i tužioca, političke partije, druga relevantna pravna lica i pojedince da predlože kandidate za izbor dvoje (2) sudija Ustavnog Suda Republike Kosovo. Takođe, jedno lice može da predloži sebe za kandidata.

Komisija posebno podstiče žene da se prijave.

**Kvalifikacije:**

Kandidati za položaj sudije Ustavnog suda moraju biti državljani Republike Kosovo; istaknuti pravnici odličnog profesionalnog ugleda, sa najmanje deset (10) godina radnog iskustva, posebno iz oblasti javnog i ustavnog prava, dokazanog, između ostalog, kroz profesionalni rad, kao: sudije, tužitelji, odvjetnici, civilni službenici ili sveučilišni predavači, te druge značajne poslova pravne prirode; osobe odličnog moralnog ugleda sa punom radnom sposobnošću, koji nisu bili kažnjavani za neko krivično djelo.

Svim predlozima i aplikacijama za nominacije moraju se priložiti dokumenta u nastavku, i to:

- Obrazac za nominiranje kandidata
- Obrazac deklaracije nominiranog
- Curriculum Vitae (C.V) ("autobiografija");
- Pismo motivacije / preporuka predlagača - organizacije / ustanove;
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o školskoj stručnoj spremi.
- Dokaz o radnom iskustvu.
- Dokaz da nisu kažnjeni za krivično delo.

Nominacije i aplikacije dostaviti najkasnije do **26. septembra 2022. godine, u 16:00 sati.**

Nominacije i aplikacije dostaviti osobno na adresi:

Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majke Tereze", bb. Direkcija personala, soba br. N-217.

Aplikacije se mogu dobiti na sledećim mjestima:

Štampani obrazac: u dotičnoj službi Administracije Skupštine Republike Kosovo ili elektronskom poštom: web stranica Skupštine Republike Kosova: [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Ostale dodatne informacije mogu se dobiti svakog radnog dana, do 16:00 sati, na telefonima: 038 211-182, 038 211-648, i 044 567-041.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

**Anayasa Mahkemesi'ne hakimlerin atanması için adaylar listesinin görüşülmesinden sorumlu Özel Komisyon'un 21 Temmuz 2022 tarihli Kararı üzerine**

**KOSOVA CUMHURİYETİ ANAYASA MAHKEMESİNE ( 2 ) İKİ  
HAKİM**

**ATAMALARIYLA İLGİLİ**

**ALENİ ÇAĞRI/ DAVET**

Anayasanın 114.1 Maddesi ve Kosova Cumhuriyeti Anayasa Mahkemesi hakkında 03/L-121 sayılı Kanununun 4 ve 6. Maddeleri uyarınca Anayasa Mahkemesine Atama Adaylarının Gözden Geçirilmesi Özel Komisyonu, Kosova Cumhuriyeti Meclisi, yargı kurumları, hukuk fakülteleri, Avukatlar Odası, Hakimler ve Savcılar Birliği, siyasi partiler, diğer ilgili tüzel kişiler ve bireyler, Anayasa Mahkemesinin seçimi iki (2) aday için, göstermek için Kosova Cumhuriyeti'nin. Ayrıca, bir kişi bir aday için kendini aday gösterebilir.

Komisyon özellikle kadınların başvuruda bulunmalarını teşvik etmektedir.

**Kalifiyeler:**

Anayasa Mahkemesi hakim görevine önerilen adaylar Kosova Cumhuriyeti vatandaşı olmalı; özellikle kamu ile anayasa hukuku alanında ve diğerleri arasında hakim, yargıç, avukat, sivil memur ya da üniversite eğitmeni olarak çalışan ve diğer önemli hukuki işlerle uğraşan en azından on (10) yıllık çalışma görgüsüne ve bununla birlikte mükemmel uzmansal ünvanına sahip ünlü hukukçular olmalı; mükemmel ahlaki ünvanına sahip olmalı ve herhangi bir suç işi için cezalandırılmış olmamalı.

Atamalarla ilgili tüm önerilere ve tüm formlara aşağıda saymış olacağımız şu evraklar ilave edilmelidir:

- Adayın atanmasına ait form,
- Atanan kişinin demeçte bulunmasıyla ilgili form,
- Curriculum Vitae (C.V) (özgeçmiş),
- Adayın önerildiği örgüt ya da kurum tarafından motivasyon belgesi,
- Kosova vatandaşı olduğuna dair delil,
- Öğretim ile uzmansal hazırlığına ait delil,
- Çalışma görgüsüne ait delil.
- Herhangi bir suç işi için cezalandırılmış olmadığına dair delil.

Atamalar ile formlar en geç **26 Eylül** tarihine ve **saat 16:00**'ya kadar gönderilmelidir.

Atamalar ile formlar şahsen şu adrese gönderilmelidir:

Kosova Cumhuriyeti Meclis Binası, Priştine, "Nëna Tereza" caddesi No'suz, Personel hizmeti, Daire N-217.

Formlar şu yerlerden alınabilir:

Basılı şekli: Kosova Cumhuriyeti Meclisinin ilgili idari hizmetinde ya da elektronik şekli: Kosova Cumhuriyeti Meclisinin [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org) web sayfasında.

Konuyla ilgili diğer ek bilgiler her iş günü saat 16:00'ya kadar şu telefon numaralarından alınabilir: 038 211-182, 038 211-648, ve 044 567-041.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -/l ada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



Nr: 621/1  
Datë: 05.09.2022

## SHPALLJE KONKURSI

Për regjistrimin e kandidatëve të gjeneratës së pestë për nivelin e 5-të, të kualifikimit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” në: 1) Qendrën e Kompetencës – Ferizaj, 2) Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” – Prishtinë, 3) Qendrën Burimore “Përparimi” – Prishtinë, Qendrën Burimore “Lef Nosi” – Prizren, dhe Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Mitrovicë për vitin shkollor 2022/2023

### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e kandidatëve

Për regjistrimin e kandidatëve për nivelin 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, për vitin shkollor 2022/2023, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e mesëm të lartë dhe janë më të vjetër se 18 vjeç.

Kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e mesëm jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin, barasvlerësimin e diplomave dhe dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurojnë për regjistrim.

Të drejtë aplikimi kanë:

1.1 Kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë (niveli 4 i kualifikimit ose më lartë).

### 2. Ofrimi i kualifikimit

Në këtë vit shkollor, kualifikimi do të ofrohet në 5 grupe – Qendrën e Kompetencës – Ferizaj, Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” – Prishtinë, Qendrën Burimore “Përparimi” – Prishtinë, Qendrën Burimore “Lef Nosi” – Prizren, dhe Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Mitrovicë. Baza e ofritit të kualifikimit është Qendra e Kompetencës në Ferizaj si Institucion i akredituar nga PEARSON.

### 3. Përfitimet për kandidatët

Të gjithë kandidatët të cilët me sukses e përfundojnë këtë kualifikim, do të pajisen me diplomë sipas standardeve të BTEC.

### 4. Kreditë

Kualifikimi për “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” zgjat një vit shkollor dhe vlerësohet me 1200 orë të Arsimit dhe Aftësimin Profesional.

### 5. Pagesa për kualifikim

Sigurimi i cilësisë së kualifikimit bëhet nga Institucioni prestigjioz britanik PEARSON. Të gjithë kandidatët të cilët pranohen për këtë kualifikim janë të obliguar që në afat prej 15 ditëve pasi të fillojnë ligjëratat, të paguajnë shumën prej 320 (treqind e njëzet ) Euro.

### 6. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Kandidatët për të konkuruar për regjistrim në kualifikimin e nivelit 5, “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” duhet të paraqesin këto dokumente:

- ✓ Fletëparaqitjen e cila merret në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr);
- ✓ Diplomën e shkollimit të mesëm të lartë, për kandidatët të cilët kanë diplomuar pas vitit shkollor 2015/2016;
- ✓ Certifikatën e shkollimit të mesëm të lartë, për kandidatët të cilët kanë mbaruar shkollimin e mesëm të lartë para vitit shkollor 2014/2015;
- ✓ Diplomë tjetër të shkollimit universitar, nëse e posedon kandidati;
- ✓ Certifikatën e vendbanimit;
- ✓ I gjithë dokumentacioni duhet të prezantohet si kopje ndërsa origjinalet për verifikim i sjellin vetëm kandidatët të cilët do të pranohen.

### 7. Afati i paraqitjes së dokumenteve, vendi dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 05 deri 16 shtator 2022.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur. Adresa: Rruga “Agim Ramadani” 10000, Prishtinë, kati i tretë duke filluar nga ora 09.00-15.30.

Kandidatët do të ftohen për testim online përmes programit të Basic Check me datë 01.10.2022

Për vendin e mbajtjes se testimit do të njoftoheni përmes email-it.

Rezultatet e testit të kandidatëve shpallen në AAAPARr, Prishtinë me datën 07.10.2022 dhe dergohen me email të kandidatët.

Kthimi i dokumenteve (orgjinali), për kandidatët të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 10 deri 14 tetor 2022, pas shpalljes së rezultateve.

Kandidatët e refuzuar në bazë të kriterëve për regjistrim kanë të drejtë që brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve të paraqesin ankesë në AAAPARr.

### 8. Kriteret e regjistrimit

Kandidatët që vlerësohen në bazë të rezultateve të testit Basic Check, do të pranohen sipas radhitjes të pikëve maksimale për secilën komunë.

### 9. Kuotat për pranimit të kandidatëve sipas komunave

Do të pranohen gjithsejt 125 kandidat për të gjitha komunat.

Me qëllim që secila komunë të mbulohet me kuadro të kualifikuara për këtë kualifikim, për këtë vit shkollor, MASHTI ka vendosur kuotat e pranimit të kandidatëve si në tabelën në vijim.

| Nr | Komuna       | Kuota | Nr | Komuna  | Kuota | Nr | Komuna        | Kuota |
|----|--------------|-------|----|---------|-------|----|---------------|-------|
| 1  | Prishtinë    | 13    | 11 | Pejë    | 6     | 21 | Suharekë      | 5     |
| 2  | Podujevë     | 4     | 12 | Istog   | 3     | 22 | Malishevë     | 3     |
| 3  | Fushë Kosovë | 5     | 13 | Klinë   | 3     | 23 | Ferizaj       | 6     |
| 4  | Obiliq       | 3     | 14 | Deçan   | 3     | 24 | Lipjan        | 3     |
| 5  | Novo Bërdë   | 1     | 15 | Gjilan  | 10    | 25 | Shtime        | 2     |
| 6  | Vushtrri     | 4     | 16 | Gjakovë | 6     | 26 | Kaçanik       | 4     |
| 7  | Mitrovicë    | 10    | 17 | Rahovec | 2     | 27 | Hani i Elezit | 2     |
| 8  | Skenderaj    | 3     | 18 | Prizren | 10    | 28 | Viti          | 3     |
| 9  | Drenas       | 3     | 19 | Dragash | 1     | 29 | Junik         | 1     |
| 10 | Kamenicë     | 4     | 20 | Mamushë | 1     | 30 | Shtërpçë      | 1     |

### 10. Fillimi i vitit shkollor

Viti shkollor do të fillojë në nëntor 2022.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

**MEKA**  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues